



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:063064

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06796707

KA.nr.399/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Ndërmarrja “IP KOS” SH.P.K, me seli në Rr. Pennsylvania Nr.41 në Marigona Residence, Preoc, Graçanicë, Republika e Kosovës, me NUI:810834673, e përfaqësuar nga B.L Drejtor Menaxhues, me përfaqësues të autorizuar avokate Blinera Osmani sipas autorizimit të datës 31.12.2024 kundër të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit Nr.Prot.36/2020 të datës 06.05.2020, pas shqyrtimit kryesor publik me datë 05.03.2024 dhe me datë 24.01.2025, në prezencë të përfaqësueses së autorizuar të paditësit dhe në prezencë të përfaqësuesve të autorizuar të paditurës, I. H.B dhe E. Sh, me datë 31.01.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “IP KOS” SH.P.K, me NUI:810834673, kundër të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me çka ka kërkuar të anulohet vendimit Nr.Prot.36/2020 të datës 06.05.2020.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 04.06.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “IP KOS” SH.P.K, me seli në Rr. Pennsylvania Nr.41 në Marigona Residence, Preoc, Graçanicë, Republika e Kosovës, me NUI:810834673, e përfaqësuar nga B.L Drejtor Menaxhues, ka parashtruar padi kundër të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me seli në Prishtinë, me kërkesëpadi për anulimit të vendimit Nr.Prot.36/2020 të datës 06.05.2020. Lënda është evidentuar me nr. A.968/20.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 3992.
3. Gjykata caktoi dhe mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik me datë 05.03.2024 dhe me datë 24.01.2025, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit dhe në prezencë të përfaqësuesve të autorizuar të paditurës, I. H.B dhe E. Sh, sipas autorizimit të datës 01.03.2024. Me propozim te palëve qe fjalën përfundimtare te dorëzojnë me shkrim, gjykata i ka obliguar qe fjalën përfundimtare te dorëzojnë ne afat prej 7 ditëve nga dita e mbajtjes se seancës respektivisht deri me date 31.01.2024.

#### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare te datës 30.01.2025 ka deklaruar se vendimi i kundërshtuar Nr 36/2020 te paditurës me të cilin pretendohet se paditësi “IP KOS” duke hyrë në marrëveshje të ndaluar apo të bashkërenduar në praktikë ka çrregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2018 ka kryer shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 përkatësisht nenit 4 “Marrëveshja e Ndaluar apo praktikë e bashkërenduar” par.1 nën par.1.1, për çka paditësi është gjobitur në shumë prej 498.338.87 €, është i përfshirë ne shkelje procedurës administrative te cilat kane te bëjnë me mosrespektimin e procedurës qe i ka paraprirë me nxjerrën e vendimit, dhe mangësitë lidhur me formën e vendimit gjegjësisht mungesën e arsytimit dhe elementeve tjera esenciale.
5. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës te vitit 2012-ligjit ne fuqi ne kohen e procedurës është përcaktuar se para shqiptimit te gjobës nga ana e te paditurës duhet te

organizohen dy seanca dëgjimore, e para e përcaktuar me nenin 47 ku mund të dorëzon prova dhe të thirren dëshmitar dhe e njëjta i paraprinë konstatimit të shkeljes së Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës kurse e dyta organizohet mbi bazën e nenit 49 të të njëjti ligj dhe objekt i saj janë vetëm kushtet për shqiptimin e gjobës apo masës tjetër ndëshkimore. Në rastin konkret e paditura ka vepruar në kundërshtim me LPPA-së dhe Nenin 38 të LKA-së, sepse seanca mbi shqyrtimin e gjobës nuk është mbajtur fare dhe nuk është ftuar edhe pse organizimi i saj është i detyrueshëm dhe imperativ për të paditurës. Mos mbajtja e kësaj seance është shkelje procedurale në raport me nenin 49 të ligjit të sipërpërmendur. Konsideron se vendimi i kundërshtuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave procedurale dhe në shkelje të ligjit material, në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian në fushën e konkurrencës dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore në rastet analoge.

6. Vendimi kontestues nuk përmban sqarim të detajuar lidhur me faktet vendimtare të cilat do ta mbështesin njoftimin e fakteve të konstatuara nga paditësi se paditësi ka caktuar çmimin shitës dhe marzhën e fitimit bruto për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2018 në mënyrë të bashkërenduar me kompanitë, madje as për marrëveshje të fshehur ose abuzim me pozitën dominuese në treg, si dhe për shqiptimin e gjobës. Konsideron se paditësi është sanksionuar nën pretendimin se nuk ka pasur çmime të njëjta me ndërmarrjet tjera në tregun e derivateve, mirëpo deklaroi se paditësi nuk ka çmime të njëjta madje as në nivel të pikave të shitjes.
7. Se pari e paditura nuk ka bërë një diferencim mes marrëveshjes së ndaluar dhe praktikës së bashkërenduar duke konstatuar se paditësi i ka kryer të dyja këto veprime të ndaluara me ligj, në kundërshtim me vet dispozitat ligjore. MPK marrëveshjet e ndaluara i definoi si dakordime ku kërkohet një dozë formaliteti, kurse praktika e bashkërenduar definoi si bashkëpunim jo formal në mes të dy apo me shumë ndërmarrjeve pa nevojën e një vendimi apo marrëveshje kurse nëse e shohim arsyetimin në asnjë vend nuk përmendet fakti se paditësi në bashkëpunim me ndërmarrjet e tjera ka lidhur marrëveshje të ndaluara në kuptim të nenin 4 dhe 5 të LMK-së, pra dispozitivi është tërësisht në kundërshtim me linjën e ndjekur në arsyetim.
8. Vendimi i të paditurës po ashtu nuk përmban përshkrim të thënieve të paditësit në seance dëgjimore apo parashtrësive të dorëzuara gjatë procedurës hetimore duke bërë që të

duket sikur paditësi nuk ka kontribuar fare e as qe ka marre pjese ne procedure. Poashtu edhe këshilla juridike e vendimit kontestues është ne kundërshtim me dispozitat ligjore meqë vetëm udhëzon paditësin qe te parashtoj padi pranë gjykatës kompetente por as nuk thekson se pranë cilës gjykate dhe nuk përcakton as afatin ligjor brenda se cilës duhet te parashtrohet padia si mjet juridik. Neni 47 dhe 48 te LPPA Parashohin qarte se këshilla juridike duhet te përmbajë organin e sakte te cilit i drejtohet dhe afatin ligjor brenda se cilës mund te parashtrohet mjeti juridik.

9. Vendimi i te paditurës poashtu është marrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material pasi që përcjellja e çmimeve të konkurrenteve nuk mund të konsiderohet si praktike e bashkërenduar. Dy aspektet kryesore ne te cikat është fokusuar e paditura është rritja e marzhave e muajve tetor nëntor 2018 dhe fakti se disa kompani e kane rritur marzhën e tyre njëkohësisht apo ne periudha konsistente. Mirëpo, nëse e shohim vendimin, i njëjti është i bazuar ne supozime dhe nuk ofron asnjë prove te prekshme për te dëshmuar një bashkërendim te ndërmarrjeve per te fiksuar çmimet e shitjes ne pakicë.
10. Paditësi i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë *Cooperatieve Vereniging "Suiker Unie" UA dhe të tjerë kundër Komisionit Evropian*, thekson se rregullat e konkurrencës nuk i privojnë OE nga e drejta e tyre qe ti adaptohen në mënyrë inteligjente sjelljes aktuale dhe të pritshme të konkurrentëve të tyre, por është i ndalueshëm çfarëdo kontakti direkt ose indirekt i operatorëve të tillë me qëllim që të ndikohet në sjelljen e tregut. Mirëpo këto veprime e paditura i ka konsideruar si te kundërligjshme mbi bazën e një punimi te quajtur Ekonomia në marrëveshje të heshtura, një analizë për nevojë të Komisionit Evropian por që nuk përbën bazë ligjore me karakter detyrues apo dokument të Bashkimit Evropian, mbi bazën e te cilit edhe është gjositur paditësi. Mirëpo në këtë punim kolizioni i heshtur nuk do te thotë detyrimisht involvimin ne marrëveshjes se heshtur apo involvimin e palëve për te marre vesh dhe komunikuar.
11. Pra vet e paditura ne vendimin e saj pranon se përshtatja e çmimeve varësisht nga konkurrenca është e ndaluar dhe nuk përmban praktike te bashkërenduar. Një shembull konkret se pse ekziston dhe nuk ka nevoja te ekzistoj është dendësia e pikave te shitjes ku brenda një hapësire prej një km gjenden 4 apo 5 pika shitës te ndërmarrjeve te ndryshme. Shembull në Çagllavicë ku kemi Shell, Ipkos, Hip Petrol etj ku ne parkun e pikës shitëse mund te shihet tabela e çmimeve te konkurrentit dhe te përshtatët çmimi pa

pasur nevojë për koordinim. Një qasje të tillë e mbështet edhe autoriteti i karteleve të Gjermanisë ku saktësisht theksohet se kompanitë e derivateve dhe menaxheret e tyre gjatë ditës sillen dy apo tre here pranë pikave shitëse të konkurrentëve dhe i kopjojnë çmimet duke mos pasur nevojë për bashkërendim. Deklaron se dallimi në çmim mes paditësit dhe ndërmarrjeve tjera të cilat janë gjobitur për pjesëmarrje në praktike të bashkërenduar është jashtëzakonisht i lartë kur e marrim parasysh marzhën e vogël të fitimit që kompanitë e naftës e kanë për një litër, si në vendimin e AK për Hip Petrol ku dallimi në çmim për periudhën kontestuese është 7 cent për produktin naftë dhe benzinë. Prandaj nuk mund të konsiderohet se ka praktike të bashkërenduar kur dihet se marzha e vogël e fitimit dhe konkurrenca e madhe në treg. Gjykatës i propozon që të nxjerre ekspertizë financiare lidhur me kalkulimin e marzhës, pra çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të produkteve naftë dhe benzinë për periudhën nëntor-dhjetor për vitet 2015-2020.

#### Kundërshtimet e të paditurës

12. Përfaqësuesit e të paditurës, në përgjigje në padi sipas parashtrës së datës 14.02.2024 dhe në deklaratimet në seancë e ka kundërshtuar kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetim se pretendimet e palës paditëse në padi janë të pa bazuara. E paditura nuk ka parashtruar fjalën përfundimtare brenda afatit ligjor. Vendimi i kundërshtuar është i nxjerrë për palën “IP KOS” SH.P.K., është fakt i pa kontestuar se ndërmarrja IP KOS ka çrregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve nëntor-dhjetor 2018 duke i shkelur dispozitat e LMK-së me saktësisht nenin 4. Duke hyrë në marrëveshje të ndaluar apo praktike të bashkërenduar me kompanitë e tjera të cilat operojnë në tregun relevant në shitjes me pakicë të derivateve të karburanteve në formë të caktimit të çmimit apo marzhës së fitimit për këta dy muaj është tregues i një praktike të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve të derivateve përfshirë paditësin IP-KOS.
13. Sa i përket kundërshtimeve në llogaritjen e marzhes së fitimit, deklaroi se dokumentacioni është siguruar nga paditësi “IP KOS” SHPK, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financave, pra janë të pabazuara pretendimet e palës paditëse për shkelje të nenit 86, 88, dhe 89 i LPPA-së sepse bashkëpunimi ka qenë me institucione kredibile që vështirë mund të rrëzohet besueshmëria në kompetencën e tyre. Autoriteti KK e ka liruar paditësin nga

hetimet për abuzim me pozitën dominuese, por nuk e ka liruar për ndikim apo që është ndikuar në sjellje veprime të kompanisë për rritjen e çmimeve të shitjes së derivateve naftë dhe benzinë gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2018.

14. Ka deklaruar deklaramet e dhëna në procesverbal tek e paditura e dëshmojnë praktikën e bashkërenduar, si bashkërendim midis ndërmarrjeve të cilat pa e arrit fazën e nënshkrimit të një marrëveshje zyrtare me dijeni kryejnë bashkëpunim praktik për të shmangur rrezikun e konkurrencës, me sjellte te tërthorta apo te drejtpërdrejta. Fakti qe çmimet e blerjeve te derivateve ne Berëz shënojnë ulje për 8% e te gjitha ndërmarrjet në vend i ngjisin çmimet 4 % fjala per produktim naft 2018, dhe mesatarja e produktit bruto shkon ne 124% kjo flet me se miri se ky treg ishte i kontrolluar dhe i marre veshur per shkak se nuk mund te ketë fitim kaq te madh pa u dhjetëfishuar numri i konsumit, po te mos ishte një marrëveshje apo praktike e bashkërenduar çmimet do te pësonin rrënje sipas logjikes ekonomike.

15. Përfaqësuesja e të paditurës ka deklaruar se vendimi i kundërshtuar është në përputhje të plotë me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së, e paditura ka ndjekur të gjitha hapat procedural në procedurë administrative, me të gjitha provat e administruara e duke përfshirë edhe ekspertizën financiare në mënyrë të pa kontestueshme vërtetohet fakti se paditësit kishtet çrregulluar konkurrencën gjatë muajve Nëntor, Dhjetor 2018 duke shkelur Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke hyrë në praktikë të bashkërenduar me ndërmarrje të tjera të cilat operojnë në tregun e derivateve të naftës ashtu që sjellja e këtyre ndërmarrjeve në mesin e të cilave edhe paditësi nuk lënë dyshim se është fjala për një praktikë të bashkërenduar. Marzha e fitimit për këta dy muaj kontestues është treguesi më i qartë për diçka të tillë. Edhe përkundër uljes së çmimeve në berzë paditësi nuk kishte zbritur çmimin dhe kjo në dëm të qytetarëve të vendit. Ekspertiza financiare tregon për një fitim enorm të paditësit gjatë muajve kontestuar në krahasim me vitet paraprake dhe duke pasur parasysh faktin se nuk ishte shumëfishuar konsumi dhe megjithatë kemi një fitim të tillë kjo nuk mund të shpjegohet ndryshe përpos një tregu të kontrolluar dhe të marrëveshur. Prandaj i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazë.

## Provat e administruara

16. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar me nr.36/2020 me datë 26.05.2020, Njoftimi i fakteve paraprake të konstatuar në procedurë me datë 21.11.2019 nga AKK për ndërmarrjen IPKOS SH.P.K, Komentet ndaj njoftimeve të fakteve të dorëzuara në AKK me datë 20.12.2019, Njoftim mbi konstatimin e gjendjes faktike me datë 21.01.2020 , Konkluzion me numër 01/19 me datë 15.02.2019, Procesverbal i seancës dëgjimore me datë 25.02.2020, Pasqyrat financiare të dorëzuara nga IP KOS SHPK për periudhën e vitit 2015, 2016,2017, 2018,2019 të gjitha këto janë pasqyra financiare që janë marr parasysh nga ekspertja gjatë hartimit të ekspertizës financiare.
17. AKK me konkluzion me nr.01/19 datë 15.02.2019, Autoriteti ka filluar procedurën hetuese për shkak të dyshimeve të bazuara për çrregullim të konkurrencës në tregun në tregun e derivateve të naftës në kundërshtim me Nenit 4 “Marrëveshje të ndaluara” dhe Nenit 11 “Abuzim me pozitën dominuese” ndaj 16 ndërmarrjeve, ku në nr. 5 është paditësi “IP KOS” SHPK për periudhën prej 01.01.2018 deri me 31.12.2018. Procedura hetimore ka filluar pas marrjes së shpjegime për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit në procedurë hetimore në sektorin e naftës me datë 30/07/2018. Paditësi “IP KOS” është njoftuar me shkresë ta datës 21.11.2019 për faktet paraprake të konstatuara në procedurë hetimore, ndërsa ka dhënë komentet lidhur me njoftimin e AKK-së me datë 20.12.2019. Me datë 31.01.2020 është njoftuar me konstatimin e gjendjes faktike. Me Ftesë të datës 31.01.2020 nga AKK është ftuar për seancë dëgjimore të mbajtur me datë 13.02.2020 të konstatuar në procesverbal të seancës dëgjimore për rastin nafta.
18. Nga Njoftimi i fakteve paraprake të konstatuara në procedurë 21.11.2019 nga AKK për ndërmarrjen IPKOS SH.P.K, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant (shitje me pakicë-naftë ), nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për muajin Nëntor e Dhjetor. Që do të thotë se, ndërmarrjet të cilat janë në procedurë hetimore, kanë pasur fitim bruto përafërsisht 9% për muajt Janar –Tetor, ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 60% dhe

për muajin Dhjetor 124%. Ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant (shitje me pakicë-benzinë), nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për muajin Nëntor e Dhjetor. Që do të thotë se, ndërmarrjet të cilat janë në procedurë hetimore, kanë pasur fitim bruto përafërsisht 12% për muajt Janar –Tetor, ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 108% dhe për muajin Dhjetor 135%.

19. Paditësi “IP KOS” SH.P.K., në komentet lidhur me njoftimin e AKK-së me nr.40/19-02/D të datës 15.12.2019, deklaron se nuk ka vepruar në kundërshtim me Neni 4 të LMK, veorimet e ndërmarrjes janë konsistente përgjatë viteve të tjera fiskale, paditësi nuk ke mëtuar në asnjë mënyrë të drejtëoëdrejtë apo të tërthortë të caktoje çmimet derivateve të naftës, apo të përfshihet në praktika të bashkërenduara. Deklaron se paditësi merr pjesë në tregun e derivateve vetëm me 6.47 %, ka vetëm 26 pika shitje me pakicë të derivateve në Kosovë, nga mbi 860 pika të tilla. Çmimet e derivateve janë të ngjashme me 0.05 € dallim në mes të furnizuesve me pakice, prandaj çmimet e identifikuar nuk përbëjnë dallim nga rregulli. Deklaron se çmimet e derivateve ne tregun ndërkombëtar nuk kanë ndikim ne çmimet përfundimtare te shitjes ne tregun e Kosovës, si shembull në shtator te vitit 2019 pas rritjes se çmimit të produkteve të naftës në bursë mbi 30%, ndërmarrja ka operuar me marzhë të papërfillshme të fitimit. Per caktimin e marzhave të sakta të fitimit është dashur të merret parasysh mestarja e ponderuar, që sipas tabelës së paraqitur nga paditësi për produktin naftë është 1.045 per benzin 0.971, e jo mesatarja e thjeshte e përdorur nga e paditura. Prandaj konsideron se nuk ka pasur, e as që ka mundësi qe te çrregulloj tregun për Shitjen e derivateve të naftës dhe benzinës, siç theksohet në Njoftimin e të paditurës po ashtu paditësi nuk ka lidhur asnjë Marrëveshje (te definuar me dispozitat e nenit 3, par. 1, nen par.. 1.1 te Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës) te ndaluar me ndonjë subjekt tjetër ekonomik, sipas dispozitave te nenit 4, par. 1 te Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

20. Nga Njoftimi për konstatimin e gjendjes faktike nga AKK, me datë 31.01.2020 me nr.30/20, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ka konstatuar gjendjen faktike sipas analizimit të dhënave, sjellja e ndërmarrjes “IP KOS” SH.P.K., në tregun përkatës ka çrregulluar konkurrencën tregtare në tregun e naftës dhe benzinës gjatë muajve Nëntor e Dhjetor të vitit 2018, e me këto veprime ka kryer shkelje të dispozitave të ligjit për



Mbrojtjen e Konkurrencë Nr. 03/L -229 konkretisht neni 4 par.1 në paragrafi .1.1, “Marrëveshje e ndaluar apo praktikë e bashkërenduar”, ndërmarrja “IP KOS” SH.P.K, në mënyrë të bashkërenduar/heshtur me ndërmarrje tjera, kanë caktuar çmimin e shitjes me pakicë të produktit naftë dhe benzinë për periudhën Nëntor e Dhjetor 2018.

21. Në procesverbal të seancës dëgjimore të datës 13.02.2020 përfaqësuesit e paditësit ka kundërshtuar vërtetimin e gjendjes faktike si të pabazuar në prova se e paditura nuk ka siguruar asnjë provë se paditësi ka hyrë në ndonjë marrëveshje me subjektet tjera. Deklaron se ndërmarrjes “IP KOS” SHPK deri në muajin tetor te viti 2018 ka punuar me humbje ndërsa në muajit e fundit nëse nuk kishin reagua me planin nuk do ti kishin mbërri profit ne fundvit. Deklaron se si kompani e çmimet i cakton ne nivel te pikës dhe jo te kompanisë, çmimet janë transparente, për shkak se si kompani operojnë në franshizës nderkombetere shpesh te tjerët kan ardhë per ti shiku çmimet per ti marre per baze. Çmimi i berzez nuk reflekton shpejt ne çmimet ne Kosove per shkak te specifikave te tregut. Kundershton konluzionet per llogaritjen e fitimit, si te gabueshme per çmimet e blerjes dhe te shitjes.

22. Në Vendimin e kundërshtuar nr.36/2020 të datës 06.05.2020, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka marr vendim duke konstatuar se ndërmarrja “IP KOS” SHPK ka çrregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2018 duke kryer shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 përkatësisht nenit 4 “Marrëveshja e Ndaluar apo praktikë e bashkërenduar” par.1 nën par.1.1. Ndërmarrjes “IP KOS” SHPK i shqiptohet masa ndëshkuese administrative në shumën prej 3%, të totalit të të hyrave për 6 mujorin e vitit 2018, në vlerë prej € 498,338.87 ndërsa ka konstatuar se ndërmarrja “IP KOS” SHPK se nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në treg individuale apo kolektive, përkatësisht nuk ka shkelje ligjore sipas nenit 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. AKK për të konstatuar marrëveshjen e ndaluar apo praktikën e bashkërenduar AKK është bazuar në nenin 3 par.1.2 si dhe në nenin 4 par1 pika 1.1 dhe nenin 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Konkluzioni i heshtur, nuk do të thotë detyrimisht involvim në ndonjë marrëveshje të heshtur apo involvim i palëve për tu marrë vesh apo komunikuar. Por ju referohet marrëveshjes së heshtur, sepse rezultati mund të ngjasoj me marrëveshje eksplicite apo edhe të një karteli zyrtar. Konkluzioni apo marrëveshja e heshtur është një sjellje e tregut që u mundëson firmave të fitojnë fitime ekstra normale ku fitimet normale

korrespondojnë me situatën e ekuilibrit. Marrëveshja e heshtur realizohet kur firmat bashkëveprojnë në mënyrë të heshtur. Atëherë ato mund të jenë në gjendje të ruajnë çmimet më të larta duke rënë dakord në heshtje se çdo devijim nga rruga e konkluzionit do të shkaktonte një hakmarrje.

23. Gjate analizës dhe përpunimit të dhënave për “IP KOS” SHPK, autoriteti ka konstatuar se nga muaji Janar – Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto për litër ka qene 0.11 cent/l, ndërsa për muajin Nentor – Dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.20 cent/l. Sipas paraleles së krahasueshmerise per muajin Shkurt –Dhjetor 2018, kur në muajin shkurt çmimi bleres/l (për litër) ishte 0.93 cent/l, çmimi shites/l ishte 1.05 cent/l ndërsa fitimi bruto/l ishte 0.11 cent/l - gjë që është reflektuese me çmimin e berzës botërore. Ndërsa për muajin Dhjetor kur çmimi i berzes kishte rënie nga muaji paraprak dhe po ashtu çmimi importues/l ishte i njejte me muajin shkurt 2018, 0.93 cent/l, çmimi shites/l ishte 1.17 cent/l ndërsa fitimi bruto/l për muajin Dhjetor 2018 ishte 0.23 cent/l, dhe gjë që ndërmarrja “IP KOS” SHPK nuk ka reflektuar me ulje të çmimit karshi çmimit të berzes dhe çmimit importues të produktit të naftës.
24. Ndërsa sa i përket produktit të benzinës nga muaji Janar – Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto për litër ka qene 0.13 cent/l, ndërsa për muajin Nentor – Dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.28 cent/l. Sipas paraleles së krahasueshmerise per muajin Shkurt – Dhjetor 2018, kur në muajin shkurt çmimi bleres/l (për litër) ishte 0.94 cent/l, ndërsa fitimi bruto/l ishte 0.12 cent/l - gjë që është reflektuese me çmimin e berzës botërore. Ndërsa për muajin Dhjetor kur çmimi i berzes kishte rënie nga muaji paraprak 0.88 cent/l, ndërsa fitimi bruto/l për muajin Dhjetor 2018 ishte 0.30 cent/l, dhe gjë që ndërmarrja “IP KOS” SHPK nuk ka reflektuar me ulje të çmimit karshi çmimit të berzes dhe çmimit importues të produktit të benzinës.
25. Sipas arsyetimit të vendimit rezulton se në mënyre të bashkërenduar me ndërmarrjet që operojnë në tregun e naftës kanë caktuar çmimin shitës në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës. sepse:
- 24.1.Gjate muajve janar - tetor ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun përkatës për produktin benzinë kanë pas një dallim të çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 12% fitimi bruto/l. Gjate muajit nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar

- tetor, çmimi blerës/l ka rënie për 5.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 7% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 108% ne raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor.

24.2. Gjate muajit dhjetor krahasuar me mesataren e muajve janar -tetor, çmimi blerës/l ka rënie për 12% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 135% në raport me periudhën e njëjte. AKK konstaton se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për Muajin Nëntor dhe Dhjetor Kanë pasur fitim bruto përafërsisht 12%, për muajt Janar-Tetor, ndërsa për muajin nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 108%, edhe për muajin dhjetor 135% në raport me periudhën Janar-Tetor.

24.3. Gjate muajve janar - tetor ndërmarrjet te cilat operojnë ne tregun përkatës per produktin naftë kane pas një dallim te çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 9% fitimi bruto/l. Gjate muajit nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës/l ka rënie për 2.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 7% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 60% ne raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor.

24.4. Gjate muajit dhjetor krahasuar me mesataren e muajve janar -tetor, çmimi blerës/l ka rënie për 8% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 124% në raport me periudhën e njëjte. AKK konstaton se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për Muajin Nëntor dhe Dhjetor Kanë pasur fitim bruto përafërsisht 9%, për muajt Janar-Tetor, ndërsa për muajin nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 60%, edhe për muajin dhjetor 124% në raport me periudhën Janar-Tetor.

24.5. Kalkulimi i sanksionit gjobës-masës ndëshkuese administrative është bërë në mbështetje të nenit 56 par1, nën par1.1 si dhe nenit 59 par.2 dhe 4 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 dhe Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-2296 për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ 01/2018 neni 3,4,8. Rasti i derivateve është për vitin 2018, ndërsa shkelja është konstatuar për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2018. Meqenëse periudha e shkeljes së këtij ligji është më e shkurtër se 6 muaj Autoriteti e konsideron si gjysmë viti dhe ndëshkimi aplikohet në qarkullimin për periudhën Korrik-Dhjetor 2018, në përputhje me nenin 4 par. 4 të UA nr.01/2018. Baza e ndëshkimit është 16,611.295.51 euro. AKK aplikon normën 3% në këtë bazë të ndëshkimit, ku në total ka përcaktuar çminin 498,338.87 euro.

25. Gjykata me propozim të përfaqësuesit të paditësi ka caktuar ekspertizë financiare për të lidhur me kalkulimin e marzhës, pra çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të produkteve naft dhe benzin për periudhën nëntor-dhjetor për vitet 2015-2020. Në ekspertizë financiare të datës 27.11.2024 të punuar nga ekspertja gjyqësore financiar Edona Uka Paci,
26. Ka konstatuar se fitimi bruto për produktin naftë Kompania IP-KOS Sh.p.k. sipas muajit në vite të ndryshme fitimi bruto deri në 0.13€-0.14€ ka arritur në muajt: Janar 2019, Shkurt dhe Mars 2020, Maj - Qershor 2017 dhe Qershor 2019, Korrik-Gusht 2015 dhe Gusht 2019 ndërsa gjatë vitit 2018 kemi fitimin bruto më të lartë në muajt Nëntor me 0.14€ dhe në muajin Dhjetor 2018 me 0.19€ që paraqet edhe fitimin bruto më të lartë të realizuar nga kompania për 6 viteve që kemi në këtë rast të analizës. Ndërsa, për produktin benzin fitimi bruto deri në 0.12€ ka arritur në muajin Maj 2017; 0.13€ në muajin Korrik për vitet 2016 dhe 2017; 0.14€ Prill 2020, 0.15€ Qershor, Gusht, Shtator, Tetor të vitit 2020; 0.16€ Shkurt 2019 dhe Mars 2020; dhe në muajin Nëntor 2018 me 0.23€, në muajin Dhjetor 2018 me 0.25€ që paraqet edhe fitimin bruto më të lartë të realizuar nga kompania për gjatë 6 viteve në këtë rast të analizës, Kjo marzhë e cila ka vazhduar me 0.19€ në muajin Janar 2019 për të vazhduar me rënje të fitimit bruto në 0.16€ në muajin Shkurt 2020.

### Baza Ligjore

26. Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës Neni 2 1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën paragrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim: 1.1. Marrëveshje - marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet

e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut.

27. Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (LMK) neni 4 përcakton marrëveshjet e ndaluara, paragrafi 1 përcakton “*Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura në mes të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikat e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që*: 1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
28. Neni 56 i LMK-së përcakton Masat Ndëshkuese për Shkelje të Rënda të Rregullave në Konkurrencën e Tregut paragrafi 1 parasheh se “*Masa ndëshkuese në një shumë deri në dhjetë përqind (10%) të totalit të të hyrave që ndërmarrja e ka realizuar në vitin e fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar, ndëshkohet ndërmarrja nëse*”: 1.1. lidhë marrëveshje të ndaluar ose në ndonjë mënyrë tjetër merr pjesë në marrëveshjen me të cilën është çrregulluar konkurrenca, në mënyrën e përshkruar në dispozitën e nenit 4 të këtij ligji;
29. Neni 59 i LMK –së përcakton Kriteret për Shqiptimin e Masave Ndëshkuese paragrafi 1 parasheh se “*Shuma më e lartë e masës ndëshkuese që mund të shqiptohet në bazë të këtij ligji në asnjë rast nuk duhet të tejkaloj shumën prej dhjetë përqind (10%) të totalit të të hyrave që ndërmarrja i ka realizuar në tri (3) vitet e fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar, sipas nenit 56 të këtij ligji*” paragrafi 2 parasheh se “*Me rastin e shqiptimit të masës ndëshkuese Autoriteti i merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese sipas peshës së shkeljes së veprës, sipas këtij ligji, kohëzgjatjes së shkeljes dhe pasojat e shkeljes për ndërmarrjet tjera në treg si dhe konsumatorët. Në këtë rast përdoret procedura e dyshkallëshe e përlllogaritjes së masës ndëshkuese administrativ në atë mënyrë që cakton bazën e shumës së masës për ndërmarrjen, atëherë shuma e përcaktuar zvogëlohet ose rritet në varësi të rrethanave lehtësuese ose rënduese*”, paragrafi 4 parasheh Rrethana lehtësuese të përcaktuara në paragrafin 2 . të këtij neni konsiderohen: 4.1. njoftimi i ndërmarrjeve për fillimin e procedurës nga Autoriteti, urgjentisht i dorëzon provat për ndërprerjen e veprimit të kundërligjshëm. Përvajshimisht, në rastin e kartelevë dorëzimi i provave për ndërprerjen e veprimit të

*kundërligjshëm nuk do të konsiderohet si rrethanë lehtësuese; 4.2. dorëzimi i të dhënave për shkeljen e këtij ligji si shkak i pakujdesisë së ndërmarrjes; 28 4.3. dorëzimi i të dhënave që ndërmarrja edhe pse është pjesëmarrës i një marrëveshje të ndaluar, nuk e ka zbatuar atë marrëveshje, respektivisht edhe pse ka ekzistuar marrëveshja, ka vepruar në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës; 4.4. bashkëpunimi i ndërmarrjes me Autoritetin i cili i tejkalon detyrimet e ndërmarrjes për lirim ose zvogëlimin e masave ndëshkimore administrative, bazuar në këtë nen.*

### Vlerësimi i gjykatës

30. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
31. Gjykata vlerëson se e paditura ka iniciuar procedurën e hetimit konform nenit Neni 35 të Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, të plotësuar dhe ndryshuar më Ligjin Nr. 04/L-226 (LMK), ku përcaktohet se Autoriteti e fillon sipas detyrës zyrtare procedurën e konstatimit të marrëveshjeve të ndaluara nga neni 4 i këtij ligji, si dhe procedura për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese nga neni 12 i këtij ligji, dhe Neni 36 të Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, e paditura me Konkluzion Nr.0119 datë 15.02.2019, ka filluar procedurës hetimore për shkak të dyshimeve të bazuara për çrregullim të konkurrencës në tregun e derivateve të naftës në kundërshtim me nenin 4 “Marrëveshje të ndaluar”, dhe nenin 11 “Abuzim me pozitën dominuese”, ndaj ndërmarrjeve të caktuara, përfshirë paditësin “IP KOS”, SH.P.K.
32. Duke vepruar në pajtim me Neni 38 të LMK ku përcaktohet Mbledhja e të dhënave nga Autoriteti i autorizuar, e paditura ka mbledhur të dhënat e nevojshme, ndërsa me Njoftimin për faktet paraprake të konstatuara në procedurën paraprake, Nr. 374/19-07/D, i datës 21.11.2019, e ka njoftuar paditësin për faktet e konstatuara në procedurën paraprake bazuar në dokumentacionin e siguruara nga Dogana e Kosovës, ATK-se dhe

paditësi, për shkeljet ligjore të pretenduara nga i padituri, si dhe e ka udhëzuar paditësin se ka të drejtë të jep komente-përgjigje në këtë njoftim.

33. Gjykata i vlerëson të pabazuara arsyetimin e paditësit të dhënë në njoftimin e AKK-së me të datës 21.12.2019, se paditësi "IP KOS" SH.P.K., si pjesëmarrës në tregun e shitjes së karburanteve me 6.47% nuk ka mundësi që të çrregullojë tregun për shitjen e produkteve të karburanteve, me arsyetim se paditësi operon në vetëm 26 pompa, sepse sipas Certifikatës së Biznesit të regjistruar në ARBK me NUI 810834673 vërtetohet se paditësi "IP KOS" SHPK, ka në dispozicion 80 njësi me aktivitet kryesor Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuara.
34. Prandaj sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes individuale në treg gjykata vlerëson se paditësi ka një pjesëmarrje të konsiderueshme me 80 pika të shitjes në treg, dhe në vlerësimin e fuqisë ndikuese në çmimet e tregut pjesëmarrja duhet të vlerësohet edhe në raport me subjektet ekonomike konkurruese që veprojnë në fushën e tregtisë së shitjes së derivateve të naftës nëse të njëjtat përfshirë paditësin kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në një treg vendor që në rast të abuzimit me çmime të produktit të rezultojë me ngritje të çmimit të produktit në dëm të konsumatorit. Pretendimi i paditësit se çmimet kanë qenë të ndryshme në pika të ndryshme të shitjes dhe pretendimi se "IP KOS" SHPK deri në muajin tetor të viti 2018 ka punuar me humbje ndërsa në muajin e fundit nëse nuk kishin reaguar me planin nuk do të kishin mbërritur profit në fundvit janë të pabazuara dhe në kundërshtim me konstatimet në ekspertizën financiare gjyqësore, sepse në ekspertizën financiare të datës 27.11.2024 të punuar nga ekspertja gjyqësore financiare me kalkulimin e marzhës, pra çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes me pakicë të produkteve naftë dhe benzinë për periudhën nëntor-dhjetor për vitet 2015-2020, është konstatuar se fitimi bruto për litër është theksuar më shumë gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018. Në muajin nëntor me 0.14€ dhe në muajin dhjetor 2018 me 0.19€ që paraqet edhe fitimin bruto më të lartë të realizuar nga kompania për 6 viteve. Ndërsa, për produktin benzinë në muajin nëntor 2018 me 0.23€, në muajin dhjetor 2018 me 0.25€ që paraqet edhe fitimin bruto më të lartë të realizuar nga kompania për gjatë 6 viteve në këtë rast të analizës.
35. Gjykata vlerëson se të gjeturat në ekspertizë janë të shkallë të lartë të përafërta me konstatimin e fakteve nga e paditura që për muajin dhjetor kishte konstatuar se kur çmimi i benzës kishte rënë nga muaji paraprak dhe po ashtu çmimi importues/l ishte i njëjte me

muajin shkurt 2018, 0.93 cent/l, çmimi shites/l ishte 1.17 cent/l ndërsa fitimi bruto/l për muajin Dhjetor 2018 ishte 0.23 cent/l. Ndërsa për muajin Dhjetor kur çmimi i berzes kishte rënie nga muaji paraprak 0.88 cent/l, ndërsa fitimi bruto/l për muajin Dhjetor 2018 ishte 0.30 cent/l, dhe gjë që ndërmarrja "IP KOS" SHPK nuk ka reflektuar me ulje të çmimit karshi çmimit të berzes dhe çmimit importues të produktit të benzinës. Kundershtimet e paditësi për llogaritjen e fitimit, si të gabueshme për çmimet e blerjes dhe të shitjes janë të pabazuara.

36. Sa i përket pretendimit se paditësi nuk ka lidhur asnjë Marrëveshje të ndaluar me ndonjë subjekt tjetër ekonomike, nuk ka marrë pjesë në marrjen e ndonjë vendimi përmes Shoqatës, nuk ka bashkërenditur praktikatat me subjektet tjera për të ndikuar me qëllim, ose që të ndikoj në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant, dhe nuk ka ndërmarre asnjë veprim, për të caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi të Benzinës dhe Naftës, Gjykata vlerëson në kuptim të nenit në kuptim të *Neni 4 të LMK –së ku definohe Marrëveshjet e ndaluara 1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura në mes të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikatat e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që: 1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;* për të ardhur deri të konstatimi nëse ndërmarrjet janë të përfshira në praktika të përbashkëta duhet të merren parasysh faktorëve të ndryshëm siç janë: *Sjellja paralele e konkurrentëve në një industri të caktuar që shfaqet me strategji të ngjashme tarifore, sjellje të tregut, apo praktika biznesi pa një shpjegim të arsyeshëm, mund të tregojë bashkëpunim ose veprim të përbashkët, shkëmbimi informacionit midis konkurrentëve në lidhje me çmimin, produktin, apo çështje të tjera të biznesit, që mund të përfshijë komunikimin e drejtpërdrejtë, apo edhe shkëmbimet e tërthorta nëpërmjet palëve të treta, Struktura e tregut gjeografik - tregu i përqendruar mund të ofrojë mundësi për bashkëpunim për shkak të presionit të reduktuar konkurrues, Analiza ekonomike që mund të përfshijë ndryshimin e çmimeve, profitabilitetin dhe faktorë të tjerë relevantë për të vlerësuar nëse veprimet janë është në përputhje me sjelljen konkurruese apo tregun bashkëpunim.*



37. Prandaj në kuptim të nenit 4 të LMK por edhe sipas praktikës në Bashkimin Evropian, nuk kërkohet që të ekzistoj një marrëveshje në formë të shkruar si provë materiale por vlerësohet se përcaktimi i praktikave të përbashkëta përfshin një analizë të sjelljes midis bizneseve që edhe pse nuk arrijnë në mënyrë eksplicite një marrëveshje për të rregulluar çmimet apo për të kufizuar prodhimin, ende koordinojnë veprimet e tyre në një mënyrë që reduktojnë apo çrregullojnë konkurrencën, marrëveshje/praktika këto të ndaluara me Nenin 101 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU).
38. Nga gjendja faktike e konstatuar në analizën e çmimeve cila gjen mbështetje edhe në deklaratimet në procesverbal të seancës dëgjimore 13.02.2020 të seancës dëgjimore të mbajtur nga AKK, përfaqësuesi i paditësit deklaroi se si kompani çmimet i cakton në nivel të pikës dhe jo të kompanisë, çmimet janë transparente, për shkak se si kompani operojnë në franshizës ndërkombëtare shpesh të tjerët kanë ardhur për të shikuar çmimet për të marrë për bazë. Çmimi i berzez nuk reflekton shpejt në çmimet në Kosovë për shkak të specifikave të tregut, sepse gjykata vlerëson se çmimet e derivateve të naftës nga deklaratimet e përfaqësuesve të paditësit rezultojnë se çmimet caktohen në mënyrë spontane, ndërsa për rritjen e çmimeve në periudhat kontestuese paditësi “IP KOS” SHPK deklaroi se deri në muajin tetor të vitit 2018 ka punuar me humbje ndërsa në muajet e fundit nëse nuk kishin reaguar me planin nuk do të kishin mbërritur në profit në fund vit, mirëpo i njëjti nuk ka dhënë asnjë arsye të besueshme apo të argumentuar se paditësi është udhëhequr nga një strategji tarifore apo një shpjegim të arsyeshem se si përcaktimi i çmimeve pasqyrohet në ndonjë plan strategjik të ndërmarrjes.<sup>1</sup> Prandaj nga kjo praktike rezultojnë se të dhënat e analizuar tregojnë bashkëpunim ose veprim të përbashkët të paditësi “IP KOS” SH.P.K., me subjektet tjera ekonomike procedurë të hetimit, duke vepruar në mënyrë të koordinuar në atë mënyrë që në muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2018 nuk kanë reflektuar individualisht në uljen e çmimit të shitjes pavarësisht rënies së çmimit importues të produktit kanë realizuar fitim bruto të dyfishuar në raport me mesataren e fitimit bruto të realizuar gjatë muajve janar-tetor 2018. Ashtu që për produktin naftë nga

---

<sup>1</sup> <sup>1</sup> GjED nw rastin 48/69, *ICI v Commission* (Dyestuffs Case), 1972 theksoi që praktikën e bashkërenduar nuk kërkon një marrëveshje formale mes ndërmarrjeve për të qenë të paligjshme. Duke zgjeruar kështu kuptimin e bashkëpunimit të ndaluar midis konkurrentëve konkurrentet e tyre veprojnë bashkërisht në treg duke përfshirë çdo formë të koordinimit që zëvendëson konkurrencën me veprime të njohura të përbashkëta. Në këtë rast, GjED vëmendje të veçantë i kushtoi mënyrës nga provat u vërtetua se vendimet e njëkohshme për ngritjen e çmimeve, së bashku me mundësinë e takimeve mes konkurrentëve përbënin prova të mjaftueshme për të mbështetur përfundimin se kishte praktikë të bashkërenduar.

janar-tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.08 cent/l ndërsa për muajin nëntor-dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.17 cent/l. Gjate muajve janar - tetor ndërmarrjet përkatëse kane pas një dallim te çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 9% fitimi bruto/l. Gjate muajit nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës/l rritet për 2.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 7%, ashtu që mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 60% ne raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor. Ndërsa, gjate muajit dhjetor krahasuar me mesataren e muajve janar -tetor, çmimi janar-tetor 2018 ka rënie për 8% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajit janar - tetor është rritur për 124% në raport me periudhën e njëjte.

39. Prandaj për arsyet e lartë përmendura rezulton se paditësi është përfshirë në praktika të përbashkëta pa marrëveshje eksplicite gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, me ndërmarrjet te cilat operojnë ne tregun relevant shitjes me pakicë të produkteve të naftës me një paralelizëm të ndërgjegjshëm, në kundërshtim Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 4 (i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligji Nr. 04/L-226) përcakton marrëveshjet e ndaluara, paragrafi 1 përcakton “Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marra ne mes te shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikat e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që”: 1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.
40. Gjykata vlerëson se sanksioni administrativ i shqiptuar është në përputhje me Udhëzimit Administrativ 01/2018, mbi Kriteret për Shqiptimin e masës së Sanksioneve Administrative, me nenin 4 par. 4, ku përcaktohet periudha e shkeljes së këtij ligji më e shkurt se 6 muaj Autoriteti e konsideron si gjysmë viti. Baza e ndëshkimit për periudhën kontestuese është marrë qarkullimi për gjashtë muaj, që është përcaktuar 16,611.295.51 euro dhe është aplikuar norma prej 3% në këtë bazë të ndëshkimit, dhe pas aplikimit të rrethanave lehtësuese është përcaktuar shuma në total prej 498.338.87 euro.
41. Prandaj, gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar Nr. 36/2020 i datës 06.05.2020 i të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, si autoritet kontraktues ka vlerësuar drejtë

gjendjen faktike kur ka konstatuar se paditësi “IP KOS” Sh.P.K. në bashkërendim me ndërmarrjet përkatëse kanë vepruar në kundërshtim me Ligjit Nr. 03/L-129 për Mbrojtjen e Konkurrencës të plotësuar dhe ndryshuar me Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.399/22, datë 31.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.